



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

NR 2500 AKTI

NR. 2232 VENDIMI

V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ,
me trup gjykues te perbere nga :

Gjyqtare ELVANA ÇIÇOLLI

asistuar prej sekretares gjyqësore **Elona Dervishi**, sot në datë 22.05.2017 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore , cështjen me nr. 2500 Akti, që i përket:

PADITËSE:

Silva LOKA, shtetase shqiptare, e bija e Vasillaqit, lindur me 03.05.1979, ne Fier, banuese ne Tirane, mbajttese e leternjoftimit nr. H95503144P, me adrese Rr. “Shyqyri Berxolli”, P. 18, Shk. 2, Ap. 13, Tirane perfaqësuar nga **Av.Florian Hasko**

E PADITUR:

Urdheri i Psikologut i Republikes se Shqiperise, perfqesuar nga Presidentja **Valbona Treska**, me adrese ne Blvd. “Gjergj Fishta”, Ndertesa 24, Kad 2, Ap. 9, Tirane përfaqësuar në gjykim nga **Av.Bledar Fejzo (ne mungese ne shpallje)**

Person i tretë:

1.Valbona Treska, me adrese ne Rr. “Myslym Shyri”, Pall. 135, Kat I (prane Shoqates se Psikologeve Ligjore), pas Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane (**ne mungesë**)

2.Keshilli Kombetar i Urdhrit te Psikologut, me adrese ne Blvd. “Gjergj Fishta”, Ndertesa 24, Kad 2, Ap. 9, Tirane(**ne mungese**)

3.Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise, me adrese ne Rrugen e Kavajes, 1001 Tirane përfaqësuar nga **Z.Aris**

Koroshi.

Me njoftimin e Avokatura e Shtetit (joprezent)

OBJEKTI

Anullimi i Vendimit Nr. 665/1 Prot., date 03.02.2017 te Komisionit te Perkohshem te Urdhrit te Psikologut dhe si rrjedhoje anulimi i procesit te votimit per zgjedhjet e para per Urdherin e Psikologut te dates 28.01.2017 dhe perseritja e zgjedhjeve per Presidentin dhe Keshillin Kombetar te Urdhrit te Psikologut

BAZA LIGJORE:

Neni 7 e vijues i Ligjit Nr. 49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar; Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise”; Ligji Nr. 40/2016, date 14.4.2016 “Per Urdhrin e Psikologut ne Republiken e Shqiperise”; Kodi i Procedures Civile.

Gjykata pasi administroi provat e paraqitura dhe shqyrtoi kërkesë padinë

Dëgjoi palën paditëse qe kerkoj pranimin e padise.

Dëgjoi palën e paditur dhe personin e tretë qe kërkoj: Rrëzimin e padisë.

VEREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë me kërkesë padinë me objekt :

“ *Anullimi i Vendimit Nr. 665/1 Prot., date 03.02.2017 te Komisionit te Perkohshem te Urdhrit te Psikologut dhe si rrjedhoje anulimi i procesit te votimit per zgjedhjet e para per Urdherin e Psikologut te dates 28.01.2017 dhe perseritja e zgjedhjeve per Presidentin dhe Keshillin Kombetar te Urdhrit te Psikologut...*”

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesë padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Në bazë të neneve 7, 8, 10, 11 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se :

Me LIGJ Nr. 40/2016 date 14.04.2016 “Për Urdhrin E Psikologut Në Republikën E Shqipërisë” eshte parashikuar krijimi i Urdhrit te Psikologut ne Republiken e Shqipërisë me qëllim :

“përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e profesionit të psikologut, garantimi i standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të psikologut”.

Në këtë ligj është parashikuar dhe procedura e zgjedhjes së organeve drejtues të tij të cilat sipas nenit 14 të ligjit janë :

- a) Asambleja Kombëtare;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Presidenti i Urdhrit;
- ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr 77 datë **09.05.2016** dhe në bazë të Neni 22 është parashikuar:

“Organizimi i zgjedhjeve të para

Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, i cili organizon zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, **brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.**

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet automatikisht.

Ligji ka hyre në fuqi 15 ditë nga botimi në fletoren Zyrtare pra në datën **24.05.2016** duke lënë afat për organizimin e zgjedhjeve të para deri në datën **24.01.2017**.

Ministra e Mireqënies Sociale dhe Rinisë ka nxjerre urdherin nr 217 të datës 03.10.2016 ku ngre komisionin e përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të psikologut në Republikën e Shqipërisë ku ka udhëzuar për disa pika për rregullimin dhe funksionimin dhe organizimin e zgjedhjes së Asamblese Kombëtare të Urdhrit.

Nga ana e Komisionit të përkohshëm janë përgatitur listat e profesionistëve psikologë të cilat sipas pretendimeve të palës paditëse janë rreth 860 në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Ky fakt nuk u kontestua as prej palës së paditur e cila nuk paraqiti një listë të numrit total.

Në vijim në datën 28.01.2017 është mbledhur Asambleja Kombëtare dhe janë zhvilluar zgjedhjet e para me qëllim zgjedhjen e Presidentit të Urdhrit të Psikologut dhe Këshillit Kombëtar. Paditësjat dhe personi i tretë kanë qënë kandidaturat për President të Urdhrit të Psikologut.

Në zgjedhje ka rezultuar ky rezultat:

Znj. Valbona Treska - 259 vota të vlefshme,

Znj. Silvana Loka - 102 vota të vlefshme

Në vijim pala paditëse Silvana Loka ka paraqitur ankese përpara Komisionit të Përkohshëm duke pretenduar parregullsi gjatë procesit të zgjedhjeve.

Komisioni I Përkohshëm me aktin e quajtur procesverbal me nr 665/1 prot date 03.02.2017 ka shqyrtuar këtë ankese duke argumentuar se:

“Komisioni i përkohshëm, duke qënë se nuk ka patur asnjë kontestim për numërimin e votave nga asnjë prej kandidatëve, do të shpallë rezultatin sipas Procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni Zgjedhor dt. 28.01.2017.

Më tej, komisioni i përkohshëm sqaron se çdo kandidat gëzoi të drejtën për të sjellë vëzhgues gjatë procesit të votimit dhe të numërimit. Në datë 27 janar kandidatët paraqitën listën e vëzhguesve përkatës, të cilët u informuan me email mbi rregulloren për të drejtat dhe

detyrimet e tyre.

Ju informojmë se vëzhguesit kanë qenë të pranishëm gjatë procesit të votimit dhe numërimit dhe nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje me sbkrim për parregullsi (pika 3 e rregullores së vëzhguesve) si rrjedhojë komisioni zgjedhor I mbështetur në rregulloren e miratuar nga komisioni i perkohshem shpall rezultatet.

Thirrja për mbledhjen e Asamblesë është bërë nga Komisioni i Përkohshëm dhe është shpallur kjo thirrje në faqen zyrtare të MMSR.

Komisioni ka për detyrë që, në përfundim të procesit, duke qenë se nuk ka patur asnjë vërejtje apo ankim ndaj procedurës së kryer nga Komisioni Zgjedhor, as gjatë, as pas votimit, të deklarojë rezultatit sipas procesverbaleve për shpalljen e fituesve të mbajtura nga Komisioni Zgjedhor. Komisioni i Perkohshëm nuk mund të bëjë asnjë interpretim të rezultatit të zgjedhjeve, por vetëni mund ta shpallë atë. Interpretimi nëse ligji kërkon apo jo kuorum për vlefshmërinë e zgjedhjeve nuk është as detyrë, as kompetencë e Komisionit të Përkohshëm, i cili vetëm organizon zgjedhjet e para

Komisioni i Përkohshëm, në të cilin Ju keni qënë anëtare, i ngritur me Urdhërin e Ministrit, ka disa muaj që funksionon. Detyrat e këtij komisioni ju janë bërë me dije që në mbledhjet e para, përkatësisht 22 shtator e të gjithë anëtarëve të këtij Komisionit i janë dërguar me e-mail, edhe në datën 23 shtator 2017. (bashkëngjitur e-mail). Gjithashtu gjeni bashkëngjitur detyrat e komisionit të Përkohshëm dhe Urdhërin e Ministrit nr.217, datë 3.10.2016.

Komisioni, në mbledhjen e datës 25.01.2017 ka shqyrtuar paraprakisht përmbushjen e kriterëve nga çdo kandidat dhe ka miratuar listën e kandidaturave. Çdo dosje e paraqitur në MMSR është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët e Komisionit edhe në datë 27.01.2017. Në përfundim, të gjitha kandidatët përmbushnin kriteret për të kandiduar referuar nenit 17, i Ligjit nr 40/2016 Për Urdhërin e psikologut”.

Asnjë kandidat nuk ishte i pajisur personalisht me listen e votuesve, por lista e votuesve, si pasqyrim i rregjistrimit (me korrektime bazuar në përgjigjet e universiteteve), u shpall publikisht në ditën e votimit, afishuar në ambjental e Qendrës Kulturore, ku u zhvillua procesi “

Komisioni i Perkohshëm ka refuzuar ankimin e paditëses Silvana Loka e cila ka qënë kandidate për Presidente të Urdhrit të Psikologut dhe ka vijuar me shpalljen e rezultateve si me poshte:

“Komisioni i Perkohshëm u njoh dhe mori në dorëzim proces verbalit e firmosura nga Komisioni Zgjedhor mbi rezultatet e zgjedhjeve, të mbajtura në datë 28.01.2017.

Komisioni i perkohshëm, mbështetur në Urdhërin e Ministrit, nr.217, datë 3.10.2016 pika 7, njofton për shpalljen e presidentit të Urdhërit të Psikologëve dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar, sipas rezultateve të paraqitura nga Komisioni Zgjedhor i Urdhërit të Psikologut. (procesverbali bashkëngjitur).

Në bazë të pikës 2. të nenit 22 të ligjit 40/2016 “Për Urdhërin e Psikologut”, me zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar, komisioni i perkohshëm shkrihet automatikisht’

Pas kësaj Urdheri i Psikologut është rregjistruar dhe me Nipt nr L71603455 G pranë Organeve Tatimore.

Pala paditëse ka pretenduar parregullsi gjatë procesit të zgjedhjeve të organeve

drejtuese te Urdhrit te Psikologut dhe ne vijim i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkallës së Parë Tirane me kërkesë padinë objekt gjykimi.

➤ Pretendimet e palës paditëse:

- Bazuar ne pjesemarrjen e psikologeve te regjistruar ne regjistrin e Urdhrit te Psikologut, mbi 860 psikologe dhe bazuar ne votat e marra nga kandidatet per Keshillin Kombetar te Urdhrit te Psikologut, konstatojme se, keto zgjedhje jane te pavlefshme sepse, jo vetem asnje prej kandidateve nuk ka marre shumicen e thjeshte te votave te te gjithë anetareve te Asamblese, mbi 430, siç e kerkon pika 3, a, e nenit 15 (Neni 15, 3. Asambleja Kombetare ka keto funksione: a) zgjedh Keshillin Kombetar dhe Presidents e Urdhrit, me votim te fshehte dhe me shumice te thjeshte te te gjithë anetareve te saj), dhe persona te regjistruar ne regjister kane qene 860, por as kuorimi per te zhvilluar zgjedhje sipas ligjit nuk ka qene ne nivelin e duhur, pasi ne zgjedhje kane marre pjese vetem 389 psikologe.
- Sic e percakon qarte germa a) e dispozites se mesiperme, Asambleja Kombetare zgjedh Keshillin Kombetar dhe Presidentin e Urdhrit "... me shumice te thjeshte te te gjithë anetareve te saj"
- Sipas neneve 7-11 te Ligjit 40/2016, rezulton se te gjithë psikologet qe jane regjistruar si votues ne ditën e votimit, pra si anetare te Asamblese Kombetare, perbejne "teresine e anetareve te Urdhrif", ne ate moment, ne kuptim te paragrafit 1 te Nenit 15 (cituat me siper).
- Sipas gernes a) te paragrafit 3 te Nenit 15, per te zgjedhur Presidenten dhe Keshillin Kombetar, duhet te kene votuar shumica e thjeshte e te gjithë anetareve te Asamblese, qe do te thote qe nuk do te llogaritet kjo shumice votash ne baze te anetareve te Asamblese te pranishem ne votim, por ne baze te numrit te pergjithshem te anetareve, pra te teresise se anetaresise. Kjo dispozite eshte e qarte dhe shprehet ne menyre taksative se cila eshte shumica e kerkuar.
- Perderisa ligjvenesi ka kerkuar qe kandidatet per President dhe anetare Keshilli te marrin shumicen e te gjithë anetareve, shpallja e fituesve nga Komisioni i Perkohshem ne kundërshtim me kete dispozite urdheruese te Ligjit 40/2016, e ben te paligjshem Vendimin 665 dhe si rrjedhoje zgjedhjen e Presidentes dhe te Keshillit Kombetar te Urdhrit ne kundërshtim me ligjin e zbatueshem (i.e. Ligji 40/2016).
- Per ta bere edhe me te qarte kete shkelje, deshirojme te sjellim ne vemendjen e Gjykates se koncepti i "shumices se thjeshte te te gjithë anetareve" te nje trupe zgjedhore, pa dyshim qe ndryshon nga koncepti i "shumices se thjeshte te tepranishmeve". Shumica e kerkuar ne rastin e pare eshte me e larte pasi bazohet ne shumicen e te gjithë anetareve, pra merr parasysh edhe numrin e anetareve qe nuk jane te pranishem per efekt te vlefshmerise se votimit.
- Perderisa ne salle nuk kane marre ne votim as V2 e personave qe kishint e drejte vote ne Asamblene Kombetare (V2 e 860 = 430), afermendsh, asnje prej kandidateve nuk do te artinte te merrte shumicen e votave kerkuar nga germa a) e paragrafit 3 te Nenit 15 te Ligjit 40/2016
- Mjafton kjo arsye qe Komisioni i Perkohshem, ose Komisioni Zgjedhor i cili ka vepruar

665/1

?

?

nen autoritetin e te parit, te anulonte procesin e vodmit dhe te riorganizonte zgjedhjet ne menyre qe te sigurohej prania e te pakten gjysmes se anetareve te Asamblese ne salle dite e votimit.

- Gjithashtu, shkelje te tjera kane te bejne me administrimin e procesit te vodmit.
- Konkretisht, anetaret e Komisionit te Zgjedhjeve, nuk kane shenuar ne procesverbal votat gjithesej, sipas gemes e) te pikes 4 te rregullores (Cdo grup numerimi, sipas kutise se votimit qe ka numeruar mban procesvetbalin perkates per numrin e votave gjithesej, numrin e votave te vlefshme dhe rezultatin per cdo kandidate, te cilat ia percjelle Komisionit te Perkohshem. Ky i fundit, pasi ka shqyrtuar edhe ankimet e paraqitura shpall yyrtarisht me shumice votash Result a tin Perfundimlar te Votimit.) pra dhe ato te vlefshme dhe te pavlefshme, por shenuan ne procesverbal vetem votat e vlefshme. Gjithashtu, duhej te ishte Komisioni i Perkohshem, sipas kesaj pike te rregullores, shpalesi i fituesit per cdo kuti, dhe jo Komisioni Zgjedhor, sikurse ka ndodhur.
- Gjithashtu, bazuar ne rregulloren e miratuar, ne piken 8 te saj, Komisioni i Perkohshem duhej te konfirmonte ligjshmerine e procesit zgjedhor (Komisioni i Perkohshem, pasi shqyrton edhe ankesat e mundshme te depozituara prane tij ne lidhje me zgjedhjet, brenda 5 diteve nga perfundimi i afatit te ankimeve, konfirmon ligjshmerine e procesit zgjedhor, shpall Presidentin e Urdhrit dhe anetaret e zgjedhur te Keshillit Drejtues.) dhe me pas te shpallte Presidentin dhe anetaret e Keshillit Kombetar. Anetaret e Komisionit te Perkohshem, te mbledhur me daten 03.02.2017, jane shprehur ne piken 2 te procesverbalit se, “.. nuk eshte detyre e tyre te interpretojne ka pasur apo jo kuorum..”, por ka qene detyre e tyre, bazuar ne rregullore te konfirmojne ligjshmerine e procesit, qe sipas pikes 3 te Nenit 15, percakton zgjedhjen e Keshillit nga nje shumice e thjeshte e te gjitha anetaresise. Anetaret e Komisionit te Perkohshem, qe perfaqesuan Ministrine e Mireqenies Sociale dhe Rinise, kane qene ne dijeni te detyrimit ligjor qe keto zgjedhje kerkojne nje kuorum te mbi 50%+1 te anetaresise, pasi ne nje pergjigjje me email, drejtuar Znj. Fiona Hasko, per shqetesimin e kesaj te fundit lidhur me pamjafmeshmerine e diteve ne dispozicion (per vetem nje jave) per te thirrur Asamblene Kombetare per votime dhe mundesine e deshtimit te zgjedhjeve per shkak te mungeses se kuorimit, te percaktuar nga pika 3 e Nenit 15, pergjigjje e derguar nga Znj. Brisida Kertusha, ku ajo eshte pergjigjnr se “... Vlefshmeria e kuorimit te votimit do te verifikohet gjate shqyrtimit te rezultateve te votimit’.
- Gjithashtu, duke qene se sipas paragrafit 2 te Nenit 22 (Organizimi i zgjedhjeve te para) te ligjit 40/2016, Komisioni i Perkohshem konsiderohet i shkrirë automatikisht, lind nevoja per caktimin nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise, si ministria pergjegjese, te nje komisioni te perkohshem te I cili duhet te miratoje nje rregullore te re e cila te parashtkoje ne menyre me te detajuar zgjedhjen e problematikave te dala gjate procesit qe i parapriu votimit, perfshire edhe vete procesin e votimit.
- Formimi i ndergjygesise eshte rrjedhoje e rrethanave faktike dhe ligjore te krijuara si pasoje e zbatimit te Ligjit 40/2016. Konkretisht, Neni 22, paragrafi 2 i Ligjit 40/2016, parashikon se “Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar komisioni i perkohshem shkrihet automatikisht. Formalisht Keshilli Kombetar eshte zgjedhur nga Asambleja e Urdhrit ne zgjedhjet e dates 28 janar 2017. Si pasoje e kesaj, Komisioni i Perkohshem eshte

zevendesuar nga Urdhri i Psikologut, ne baze te pasojave ligjore qe ka krijuar Vendimi Nr. 665/1 Prot., date 03.02.2017 i Komisionit te Perkohshem. Ne baze te ketij Vendimi eshte ezauruar shqyrtimi i ankesave te kandidatëve dhe Komisioni i Perkohshem ka konfirmuar sipas tij (vendimmarje qe ne e kundërshtojme me ane te padise) zgjedhjen e Presidentes dhe te Keshillit Kombetar. Njekohesisht ky Vendim shenon edhe castin e shkrirjes se Komisionit te Perkohshem. Perderisa ky Vendim ka krijuar pasoja ligjore qe ka prekur te drejtat e Paditeses dhe interesat e saj te ligjshme, eshte e drejte e saj te kundërshtoje Vendimin Nr. 665/1 Prot., date te Komisionit te Perkohshem. Duke qene se Komisioni i Perkohshem eshte shkrirë eshte thirrur Urdheri i cili e ka zevendesuar, per me teper qe zgjedhjet e kontestuara nga Paditesja jane kryer ne kuader te Urdhrit. Po te pranojme llogjiken e perfaqesuesit te te Paditurit, rezulton se Paditesja s' duhet te ngrinte padi fare meqenese s'ka se ke te padise.

- Referenca ne Nenin 22, paragrafi 1 i Ligjit 40/2016, sipas te cilit Komisioni i Përkohshëm duhet te organizoje zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e Ligjit eshte irrelevante per ceshtjen. Keto jane afate indikative, njejte me ato te parashikuara ne te gjithë ligjet qe kane nevojë te plotesohen me akte nenligjore. Per me teper, formalisht ky afat lidhet me ngritjen e Komisionit ne fillim dhe nuk pengon perseritjen e procesit si pasoje e vendimit te gjykates, ne rastin qe kjo do te pranonte padine tone. Gjithashtu, perseritja e procesit te zgjedhjeve eshte nje kerkim qe lidhet me rregullimin e pasojave te paligjshmerise se Vendimit Nr. 665/1 Prot., date 03.02.2017 te Komisionit te Perkohshem. Thirrja e Ministrise si person i trete ka pikerisht kete synim, qe kjo pale te njohet me vendimin e gjykates ne rast pranimi te padise, duke qene pale ndergjygjese per shkak se ka nje interes ne zgjidhjen e ceshtjes per shkak te tagreve dhe detyrave te titullarit te saj sipas dispozites tranzitore te parashikuara nga Neni 22 (Organizimi i zgjedhjeve te para) te Ligjit 40/2016.
- Ne lidhje me thirrjen e Znj. Treska dhe Keshillit Kombetar si persona te trete ne gjykim, deshirojme te theksojme se Znj. Treska eshte thirrur si Presidente e zgjedhur e Urdhrit dhe jo si individ dhe se te dy keto organe te Urdhrit, jane te parashikuara ne vete Ligjin 40/2016. Konkretisht Presidenti i Urdhrit eshte organ individual, ndersa Keshilli Kombetar eshte organ kolektiv dhe thirrja e tyre bazohet ne faktin qe ndersa Presidentja perfaqeson Urdherin, Keshilli Kombetar eshte orgaru me ngritjen e te cilit, shenohet edhe penudha tranzitore sipas Neni 22 cituar me siper. Per keto arsye, prania e ketyre dy organe si persona te trete ka rendesi per procesin dhe zhvillimin e tij sipas parimeve te procesit te drejte ligjor.
- Per themelin e ceshtjes, argumentimin tone ligjor per kete ceshtje e kemi ezauruar me siper, kur kemi shpjeguar qarte qe Neni 15, paragrafi 3, germa a) e tij percakton se Asambleja Kombetare zgjedh Keshillin Kombetar dhe Presidentin e Urdhrit "... me shumice te tbjeshte te te gjithë anetareve te saj! Ky formulim perjashton interpretimin e perfaqesuesit te te Paditurit se vendimi eshte i vlefshem nese kane votuar pro shumica e anetareve pjesemarres ne votim. Qellimisht i Padituri kerkon te krijojë konfuzion duke permendur ceshtjen e kuommit, kur ne fakt dispozita e mesiperme nuk ka te beje me kuorumin — koncept i lidhur me vlefshmerine e mbledhjes, por me shumicen e kerkuar per zgjidhjen e organeve te Urdhrit — koncept qe ka te beje me vlefshmerine e vendimit!

Gjithashtu, është jo relevant referimi në dispozitat ligjore për funksionimin e organeve të enteve publike, përderisa lex specialise në rastin tone Ligji 40/2016 ka një parashikim të posaçëm për këtë çështje.

- Në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, Vendimi Nr. 665/1 Prot., datë të Komisionit të Përkohshëm të Urdhrit të Psikologut është i paligjshëm për shkak se nuk ka respektuar ligjin material (shumica e kërkuar për vlefshmerinë e zgjedhjeve sipas Nenit 15, paragrafi 3, germa a) e ligjit 40/2016). Për këtë arsye kemi kërkuar anulimin e këtij Vendimi dhe rregullimin e pasojave që burojnë prej pranimit të këtij kerkimi, në rastin e pranimit të Padisë, sic kemi shpjeguar më sipër.

➤ Pretendimet e palës së paditur:

- Objekt i padisë është anulimi i vendimit të Komisionit të Përkohshëm për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve të para të mbajtura në Asamblenë e parë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut. Ky Komision është ngritur sipas ligjit 40/2016 “Për Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë” me Urdhër të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Sipas ligjit, vetëm ky Komision ka ekskluzivitetin e organizimit të zgjedhjeve të para për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut dhe shkrihet automatikisht pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve.
- Aktualisht, ky organ, i cili nuk është një organ administrativ dhe të cilit ligji nuk i ka njohur ndonjë personalitet juridik të pavarur, me përmbushjen e detyrimeve ligjore është shkrire, pra nuk ekziston dhe kompetencat e tij ekskluzive për organizimin e zgjedhjeve nuk mund t’i marrë asnjë organ tjetër.
- Në këtë kuptim, thirrja në cilësinë e palës së paditur të Urdhrit të Psikologut është e gabuar, pasi në lidhje me këtë kërkim, ky ent nuk e gëzon legjitimitimin pasiv dhe nuk i lind asnjë detyrim nga çdo lloj vendimmarrjeje në lidhje me këtë kërkim. Asnjë nga të drejtat dhe detyrimet e Komisionit të Përkohshëm nuk i kalon me ligj Urdhrit të Psikologut.
- Pretendimi i ngritur në padi se Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë mund të thërrasë një komision të ri të përkohshëm është i pabazuar në ligj. Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 22 të tij, “Organizimi i zgjedhjeve të para”, përcakton se: “Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, i cili organizon zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” Ky afat ka kaluar. Gjithsesi, kërkitimi në objekt të padisë, për përsëritjen e procesit të zgjedhjeve të para, nuk është një kërkim që mund t’i drejtohet palës së paditur.
- Në mendojmë se jemi në kushtet e një padie që nuk mund të ngrihet, pasi mungojnë parakushtet proceduriale për ngritjen e saj. Në vendimin nr. 351, dt. 05.06.2014, Gjykata e Lartë, në një trajtim teorik të cilësive që duhet të ketë një padi, që të mund të shqyrtohet nga gjykata, analizon se:
“Kështu, në interpretim të dispozitës së nenit 468 të K.Pr. Civile, duhet të mbahet parasysh se padia nuk mund të ngrihet në rastet e mungesës të parakushteve procedurale, si ekzistenca e gjyqvarësisë (neni 58 i K.Pr.Civile); mungesa e zotësisë së palëve (nenet 33 dhe 91 të K.Pr.Civile); dhe në raste të mungesës së kushteve themelore të padisë, të

tilla si mungesa e legjitimitetit formal dhe interesit për të ngritur padi (neni 184 i K.Pr.Civile), si dhe kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet vendimit të gjykatës nuk është parashikuar. Parakushtet procedurale janë kushte për krijimin e marrëdhënies procedurale; mungesa e tyre nuk pengon inicimin e procesit, por përbën pengesë për shqyrtimin e themelit të çështjes. Në këtë kuptim arrihet në konkluzionin se mungesa e legjitimitetit procedural (formal) pas sjell pushimin e gjykimit të padisë, ndërsa mungesa e legjitimitetit substancial pas sjell rrëzimin e saj, pasi legjitimiteti formal gjen rregullim në normat procedurale ndërkohë që pasja e legjitimitetit aktiv apo pasiv është një çështje që zgjidhet nga normat materiale. Pra legjitimiprocedural është kushtë për vazhdimin e gjykimit, ndërsa legjitimimi aktiv dhe pasiv i takon shqyrtimit gjyqësor të themelit të çështjes, për të cilin gjykata shprehet në vendimin përfundimtar.

- Neni 31 i K.Pr. Civile, i cili përfaqëson interesin e ligjshëm, përcakton edhe pozitën e palëve në proces. Kështu, personi që, duke pretenduar se e drejta subjektive i takon atij, i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e kësaj të drejte të shkelur nga një person tjetër që e thërret në gjykim rregullisht, quhet paditës dhe gëzon legjitimitetin aktiv. Ndërsa, personi të cilit i drejtohet kërkimi, duke pretenduar se është ky person që ka shkelur, cenuar apo mohuar të drejtën e paditësit, quhet i paditur dhe ka legjitimitet pasiv.
- Në thelb, ngritja e padisë, hartimi dhe paraqitja e kërkesëpadisë, janë mjete procedural me të cilin paditësi vë në lëvizje gjykatën, kur pretendon se ka një të drejtë subjektive, për të njohur a mbrojtur, e cila gjen mbështetje në të drejtën pozitive, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe nga ajo procedurale (për t'iu drejtuar gjykatës). Nëse ajo që, konkretisht, paditësi pretendon se i është cenuar apo që duhet t'i njihet, parashikohet nga e drejta pozitive në aspektin material, e akoma më tej, nëse e drejta pozitive i njeh paditësit të drejtën që këtë të kërkojë ta realizojë nëpërmjet gjykatës, atëherë gjykata ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes për të verifikuar nëse ajo kërkohet konkretisht me padi (në objekt) është e mbështetur edhe në prova e në ligj.
- Gjithashtu, thirrja në këtë proces në cilësinë e personit të tretë të znj. Valbona Treska në cilësi individuale është e gabuar. Nëse pala paditëse çmon se gjykim të gjithë personat të cilët janë shpallur fitues nga zgjedhjet e para, atëherë duhet të thërrasë nominalisht në gjykim edhe të gjithë anëtarët e zgjedhur të Këshillit Kombëtar. Thirrja gjithashtu e Këshillit Kombëtar në cilësinë e personit të tretë është e gabuar, pasi ky organ nuk ka personalitet të pavarur juridik.
- Bazuar në sa më sipër, jemi përpara një padie të ngritur në mënyrë të gabuar dhe me ndërgjyqësi të gabuar, e cila nuk parashikohet që mund të ngrihet nga e drejta ç pozitive.
- Nga ana tjetër, shkresa që kërkohet të goditet gjyqësisht, nuk është një akt administrativ, pasi nuk është një akt i nxjerrë nga organet e administratës publike. Ligji e trajton Urdhrin e Psikologut si një ent publik të pavarur, mënyrë e funksionimit të të cilit rregullohet në bazë të akteve themeluese të tij. Edhe krijimi i një Komisioni të Përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve të para, është një zgjidhje e ligjvënës për të mospërfshirë asnjë organ të administratës publike në krijimin e këtij enti, duke respektuar parimin e autonomisë dhe pavarësisë së tij nga çdo organ shtetëror. Në këtë mënyrë, çdo vendim i marrë nga organet e përkohshme apo të përhershme të Urdhrit të Psikologut, nuk janë

- akte administrative dhe nuk goditen si të tilla gjyqësisht, por mënyra e kufërshimit të tyre parashikohet në aktet themeluese të cilat miratohen nga Asambleja Kombëtare.
- Lidhur me themelin e pretendimeve të ngritura në padi, çmojmë se: Pretendimi në lidhje me kuorumin dhe shumicën e kërkuar për shpalljen e fituesve është i pabazuar në ligj.
 - Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhrit e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” në asnjë rast nuk përcakton kuorum për vlefshmërinë e mbledhjeve të Asamblesë Kombëtare.
 - Asambletë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, si rregull me praninë e të gjithë anëtarëve, por edhe me një anëtarësi më të pakët në numër. Në aktet e krijimit të tyre, siç është në rastin konkret ligji i posaçëm, mund të përcaktohen rregulla që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm, që Asambleja të marrë vendime të vlefshme. Në rastin konkret, ligji nuk ka përcatuar asnjë kuorum për vlefshmërinë e mbledhjes së asamblesë në asnjë rast. Kjo është e zakonshme për të gjitha asambletë që përbëhen nga një numër i konsiderueshëm anëtarësh. Në të gjitha rastet e enteve publike, nuk ka asnjë rast, në asnjë ligj të ngjashëm, që të vendimmarjen e asambleve.
 - Pra, në çdo rast, që Asamblesë nuk i kërkohet një kuorum i caktuar për vlefshmërinë e vendimmarrjes, çdo vendim që merret nga Asambleja e thirrur rregullisht, është i vlefshëm.
 - Neni 15.3, gërma a) e ligjit 40/2016 përcakton llojin e shumicës së kërkuar për shpalljen fitues të kandidatëve. Ky nen përcakton në mënyrë të shprehur se lloji i shumicës së kërkuar është shumica e thjeshtë.
 - Koncepti i shumicës së thjeshtë është një nga konceptet më primare në teorinë e zgjedhjeve. Shumica e thjeshtë, nënkupton se shpallet fitues kandidati, që mbledh më shumë vota të vlefshme nga të gjithë kandidatët e tjerë pjesmarrës në garë. Për efekt të llogaritjes së shumicës së thjeshtë konsiderohen vetëm votat e vlefshme të tërësisë së votuesve. Çdo interpretim tjetër i kësaj dispozite vjen në kundërshtim me parimin e shumicës së thjeshtë, të përcaktuar shprehimisht në ligj. Ligji në mënyrë të qartë përcakton se organet drejtuese zgjidhen me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve. Kjo do të thotë se të gjithë anëtarët thirren në votim, dhe në kushtet kur nuk ka të përcaktuar një kuorum, kandidatët fitues janë ata që kanë marrë shumicën e votave të vlefshme.
 - Interpretimi se organet drejtuese zgjidhen me 50+1% të anëtarëve të regjistruar në Asamble, vjen në kundërshtim të hapur me ligjin.
 - Shumica 50+1% është një shumicë e cilësuar (në këtë rast shumicë absolute, si një nga llojet e shumicave të cilësuar). Nëse ligjvënësi do të kishte për qëllim vendosjen e një shumice të cilësuar (50+1% të anëtarëve të regjistruar), nuk do të kishte specifikuar në menyrë të shprehur se organet drejtuese zgjidhen me « shumicë të thjeshtë ».
 - Edhe në interpretimin literal të dispozitës, “shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve” të Asamblesë, është shumica e thjeshtë e Asamblesë, pasi referuar nenit Neni 15 të ligjit 40/2016, tërësia e anëtarëve, nuk është gjë tjetër përveçse Asambleja Kombëtare (citoj: Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtuës i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.) Pra, edhe në interpretimin literal të kësaj dispozite, nëse zëvendësojmë termin “të të gjithë anëtarëve”, me termin e barazvlefshëm sipas nenit 15 “Asambleja”, dispozita përcakton qartë: Asambleja zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhërit, me votim të fshehtë dhe shumicë të thjeshtë të Asamblesë (të

saj)”.

- Siç është lehtësisht e kuptueshme, çdo pretendim në padi lidhet me konceptin e “shumicës së thjeshtë”, që s’është gjë tjetër veçse shumica relative e votave të vlefshme, duke përfshirë edhe abstenimet Pra, edhe në themel, pretendimi se Asambleja ka marrë një vendim për zgjedhjen e organeve të larta drejtuese të Urdhrit të Psikologut pa kuorumin e nevojshëm nuk është i bazuar në ligj.
- Po njësoj, pretendimi se për zgjedhjen e organeve drejtuese ligji ka përcaktuar një shumicë të cilësuar (50+1% të anëtarëve të regjistruar) nuk është i bazuar në ligj.
- Përfundimisht, përderisa nuk kërkohet një kuorum i caktuar për vlefshmërinë e vendimmarrjes së mbledhjes së Aamblesë dhe shumica që kërkohet në këtë votim është « shumicë e thjeshtë », Komisioni i Përkohshëm ka zbatuar drejt ligjin duke proceduar me shpalljen e rezultateve të votimit.

➤ Pretendimet e personit të tretë

- Ministria e Mireqenies sipas ligjit nr 40/2016 “Per urdherin e psikologut“ pikes 22 te saj eshte marre me organizimin e zgjedhjeve sic eshte parashikuar ne piken 1 te nenit 22. MMSR ka ofruar bazen teknike si dhe ka here lajmerimet e duhura per pjesemarrjen ne votime dhe takimet e asamblese se perkohshme. Ne zbatim te ligjit MMSR ka nxjerre urdherin nr 217 te dates 03.10.2016 ku ngre komisionin e perkohshem per organizimin e zgjedhjeve per organet drejtuese te Urdhrit te psikologut ne Republikën e Shqipërisë ku ka udhezuar per disa pika per rregullimin dhe funksionimin dhe organizimin e zgjedhjes se Asamblese Kombetare te Urdhrit. Te gjithë subjektet pjesemarrës ne kete urdher kane derguar pjestet e tyre per mbarevajtjen e ketij procesi te pasqyruar dhe ne urdher.
- Me organizimin e zgjedhjeve ku MMSR kishte pjesmarrje e saj ne llogjistiken e kerkuar per mbarevajtjen e procesit te zgjedhjeve, per pjesmarrje cdo anetar i propozuar dhe i certifikuar nga komisionet e ngritura per verifikimin e dokumentacionit te kandidateve si per president te Urdhrit si dhe kandidatet per anetare te kryesise kane qene te paisur me vezhgues te procesit deri ne numerimin dhe shpalljen e rezultateve. Jane kryer deklaratat personale te komisionit zgjedhor eshte ngritur nje rregullore per mbarevajtjen e zgjedhjeve dhe detyrat dhe te drejtat e vezhguesve si dhe per organizimin dhe funksionimin e zgjedhjeve nuk ka pasur asnje ankese. Znj Loka kryen nje ankese me nr 617 date 30.01.2017 ku i eshte drejtuar komisionit te perkohshem te ngritur me urdherin e ministrit dhe i kthyer pergjigje per ceshtjen e mesiperme.
- Ne kerkese padine e paraqitur nga pala paditese padite urdheri i psikologut ku ku urdher eshte ngritur sipas ligjit nr 40/2016 me urdherin nr 217 te dates 03.10.2016 te Ministrit te MMSR i cili ne momentet e shpalljes se rezultatit te zgjedhjeve eshte shkrire automatikisht. Persa me siper eshte nje organ i cili ka pushuar ekzistencen e tij pasi i ka permbushur qellimin e ngritjes se tij dhe nuk ka fuqi te veprime pas shpalljes te fituesve te Keshillit Kombetar te Urdhrit te psikologut. Pra qe ne thirrjen e ketij organi si pale e paditur ky urdher nuk ka legjitimitet pasiv dhe nuk mund te kryej asnje veprim sipas ligjit. Per shkak te kalimit te afateve ligjore sipas ligjit qe MMSR nuk mundet te ngreje nje komision tjetër te ri qe te kryejë zgjedhje te reja jemi ne rastin ku MMSR nuk mundet ta

ngreje dot kete komision pasi organizimi i zgjedhjeve duhet te kryet brenda afatit 8 mujor i cili eshte afat qe ka kaluar sipas nenit 22 te ligjit. Ne te gjithe proceduren e kryer nga MMSR ky eshte i vetmi rast qe eshte ankuar prane gjykates nga te gjithe kandidatet pjesmarres ne zgjedhje. Duke pare rezultatin e zgjedhjeve ku znj Loka ka marre me pak se nje te terten e votuesve mendojme se edhe po te qendronte pretendimi qe nuk eshte arritur korumi per te vendosur kush do te jete presidente e Urdhrit, znj ne fjale do ti duheshin te pakten edhe 200 vota te tjera. Diferenca e madhe e votave nga fituesja te znj Loka e ka te shteruar se kush eshte presidenti i Urdhrit te psikologut. Lajmerimi per pjesmarrjen qe te votojne te tere anetaret eshte kryer rregullisht nga institucioni jone dhe nuk ka pasur kundershtrim per kete pjese. Ndergjyqesia ne kete kerkese padi eshte kryer ne menyre te gabuar. Ne nenin 18 te ligjit 40/2016 e ka lene te hapur zgjedhjen e presidentit te Urdhrit duke e cilesuar dhe e saktësuar konceptin e nenit 15 pikes 3 te cilin pala paditese e arsyeton se duhet te jete ne menyren 50 perqind plus 1.

Arsyetim ligjor

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarive qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor i veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë.

Gjykata merr ne shqyrtim elementet proceduriale dhe materiale te kësaj kërkesë padie me qëllimi e vetëm për respektimin e Ligjit dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

➤ Nga pikëpamja Procedurale:

Juridiksioni

Nga ana e palës së paditur u pretendua se jemi perpara nje kerkese padie qe nuk mund te ngrihet.

Ne lidhje me sa me siper Gjykata cmon se ky vendim është ne zbatim te nenit 1 te Kodit te Procedures Civile sipas te cilit:

“ Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji nungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.”

Organizimi i zgjedhjeve per Presidentit dhe Keshillin Kombëtare është bazuar në Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, I cili në nenin 22 të tij, “Organizimi i zgjedhjeve të para”, përcakton se:

“Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me urdhër, ngre një komision të përkohshëm, i cili organizon zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” .

Në zbatim te dispozitës së mësipërme nga ana e Ministrise se Mireqënies Sociale dhe Rinise është nxjerrë urdheri nr 217 te dates 03.10.2016 me anë të të cilit është kompozuar komisioni i perkohshem per organizimin e zgjedhjeve per organet drejtuese te Urdhrit te

psikologut ne Republiken e Shqiperise ku ka udhezuar per disa pika per rregullimin dhe funksionimin dhe organizimin e zgjedhjes se Asamblese Kombetare te Urdhrit.

Gjykata cmon se nëpërmjet Urdhrit të ngritjes se komisionit te përkohshem Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinise si organ publik ka transferuar kompetencat e saj me karakter publik dhe administrativ me qëllim organizimin e Urdhrit te Psikologut.

Në këtë këndvështrim veprimtaria e Komisionit te Përkohshem është pasqyrimi i autoritetit publik sic është Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinise. Shkrimja e këtij komisioni nuk eliminon karakterin administrativ te veprimtarise se realizuar prej tij dhe ligjeron pjesemarrjen e Ministrise ne kete proces gjyqësor.

Cilësia si ent publik i Urdhri te Psikologut rregullohet Sipas nenit 5 te ligjit nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë” :

“ Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, në vijim Urdhri i Psikologut, është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbrohet interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.”

Kjo ne kuptim te nenit 1 te ligjit Nr.8480, date 27.5.1999 Per Funksionimin E Organeve Kolegjiale Te Administrates Shtetore Dhe Enteve Publike con ne konkluzionin se:

“Me ent publik për qëllimet e këtij ligji do te kuptohet çdo subjekt i se drejtës publike joshtetor, i krijuar me ligj dhe qe synon realizimin e një interesi publik.”

Në këtë këndvështrim edhe procesi i përzgjedhjes dhe kompozimit te organeve drejtuese është në përputhje me këtë karakter publik.

Kodi i Procedurave Administrative gjen zbatim ne rastin konkret duke iu referuar nenit 2 sipas te cilit:

“1.Ky Kod zbatohet kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative:

a) vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ;

b) lidh një kontratë administrative apo kryen një veprim tjetër administrativ, i cili ka të bëjë me të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave.

2. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për rastet kur:

a) personat juridikë, publikë apo privatë, që ushtrojnë funksione vetë-rregulluese në fushën e profesioneve të rregulluara, të krijuara me ligj apo që u është dhënë e drejta e ushtrimit të këtyre funksioneve, në bazë të legjislacionit në fuqi, vendosin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

Nga sa më sipër Gjykata cmon se ka juridiksion për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarise dhe procesit te përzgjedhjes së organeve drejtuese te Urdhrit te Psikologut si ent publik.

Legjitimimi

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative te Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padinë objekt gjykimi në cilësinë e njerës prej konkurrenteve per te ushtruar funksionin si Presidente e Urdhrit te Psikologut i cili tashme ekziston se eshte i regjistruar

rregullisht. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 49/2012, dt. 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

"të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik,"

Në rastin konkret pala paditëse legjitimohet pjesërisht nga pikëpamja procedurale duke qënë se plotëson pjesërisht kushtet e parashikuara nga neni 15d e ligjit nr. 49/2012, dt. 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Në cilësinë e kandidates për Presidente të Urdhrit të Psikologut ajo nuk legjitimohet në kundërshtojë procesin dhe rezultatin e zgjedhjeve përse i përket Këshillit Kombëtar.

Në lidhje me këtë konkluzion Gjykata cmon ti drejtohet trajtimit doktrinor në lidhje me ekzistencën e interesit për grtitjen e padisë:

Pa interes, nuk ka padi. Ky postulat e ka zanafillën qysh në periudhën romake ku ka lindur dhe vetë koncepti i padisë.

Doktrina franceze e përcakton interesin në këtë mënyrë *"Interesi është masa e padive"*. Nëse ushtrimi i një padie nuk i siguron paditësin një avantazh, atëherë autoritetet gjyqësore duhet ta deklarojnë këtë padi si të papranueshme dhe të mos e shqyrtojnë në themel. Palët në një proces civil duhet të kenë legjitimitet. Kështu *"si për të parashtruar një kërkim në gjykatë ashtu dhe për të kundërshtuar këtë kërkim është e domosdoshme të kenë një interes të ligjshëm"*.

Që një person të ketë të drejtën për të përfituar nga mbrojtja që i ofrojnë organet shtetërore për realizimin e një të drejte që i cenohet, duhet që individi të ketë interes për mbrojtjen e kësaj të drejte.

Interesi si i palës paditëse ashtu dhe i palës së paditur duhet të jetë:

1. legjitim dhe juridik;
2. personal dhe direkt;
3. I lindur dhe aktual.

Këto karakteristika të interesit edhe pse nuk janë të shprehura në ligj, doktrina i ka përcaktuar si kriteret, mungesa e njërit prej tyre do të sillte mungesën e legjitimitetit. Analizimi i secilit prej këtyre elementëve është tepër i rëndësishëm për të arritur në një konkluzion të drejtë nëse një person ka ose jo interes për ngritjen e një padie.

Interesi legjitim ka të bëjë me faktin që paditësi mund të ushtrojë të drejtën e padisë vetëm kur atij i është cenuar, mohuar ose shkelur një e drejtë që atij i është njohur nga ligji. Pikërisht këtë parashikon dhe paragrafi i parë i nenit 32 të K.Pr.Civile. Pa ndërhyrjen e gjykatës, paditësit do t'i vijë një dëm dhe pikërisht shmangia e këtij dëmi nga veprimet ose faktet e një personi tjetër, i jep të drejtë atij të veprojë në gjykim. Pra, e drejta që paditësi kërkon të realizojë duhet të jetë juridikisht e mbrojtur dhe e parashikuar në ligj.

Sipas doktrinës italiane ekzistojnë dy teori, të cilat japin përkufizimin e interesit për të vepruar në gjykim.:

"Teoria e parë e lidh interesin për të vepruar me një gjendje cenimi ose shkelje të së drejtës"

që kërkohet të njihet, ndërsa teoria e dytë sheh të pasqyruar në parimin e interesit për të vepruar, kërkimin (nevojën, pretendimet) e personit që përfiton nga e drejta që vetë ligji ia njeh, kërkim i cili mund të pretendohet në organin gjyqësor vetëm nëse ky organ përfaqëson mjetin e fundit për subjektin”.

Interes i ligjshëm do të thotë që personi të gëzojë një të drejtë subjektive dhe për mbrojtjen e kësaj të drejte, justifikohet për ngritjen e një padie.

Kuptimin e interesit juridik e ka shpjeguar dhe Gjykata e Lartë në vendimin nr.30, datë 13.01.2005, në të cilin arsyeton se

“Nga të dhënat e akteve të ndodhura në dosje rezulton se interesi i palës paditëse është juridik, pasi është i mbështetur mbi një të drejtë që gëzon njohje e mbrojtje nga ligji ”.

Interesi juridik mund të jetë moral dhe pasuror. Pra mjafton që të kesh një interes sado i vogël të jetë ai dhe personi ligjërisht mund të ushtrojë të drejtën e padisë.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se pala paditëse ka interes për paraqitjen e kësaj kërkesë padie vetem përse i përket procedurës dhe rezultateve për zgjedhjen e Presidentit të Urdhrit të Psikologut.

Nga pala e paditur u pretendua se pala paditur dhe personat e trete nuk legjitimohen pasivisht. Në lidhje me sa më sipër Gjykata e cmon se ky pretendim konsiderohet i pambshtetur në ligj pasi Urdhri i Psikologut, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut dhe vecanërisht Presidentja e Urdhrit të Psikologut kanë interes në zhvillimin e këtij gjykimi.

Pavarësisht se ehte kundërshtuar një akt i cili është lëshuar nga Komisioni i Përkohshëm i cili nuk ekziston më, pasojat e tij janë të lidhura me organet e zgjedhura të Urdhrit të Psikologut. Në këto kundërshtime pala e paditur dhe personat e trete legjitimohen pasivisht në këto procese.

Me lart është sqaruar se nga ana e Ministrisë së Mireqënies Sociale dhe Rinisë është nxjerrë urdhri nr 217 të datës 03.10.2016 me anë të të cilit është kompozuar komisioni i përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë ku ka udhëzuar për disa pika për rregullimin dhe funksionimin dhe organizimin e zgjedhjes së Asamblesë Kombëtare të Urdhrit.

Gjykata e cmon se nëpërmjet Urdhrit të ngritjes së komisionit të përkohshëm Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinisë si organ publik ka transferuar kompetencat e saj me karakter publik dhe administrativ të Komisionit të Përkohshëm.

Në këtë kundërshtim veprimtaria e Komisionit të Përkohshëm është pasqyrimi i autoritetit publik siç është Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinisë. Shkrirja e këtij komisioni nuk eliminon karakterin administrativ të veprimtarisë së realizuar prej tij dhe legjitimon pasivisht Ministrinë e Mireqënies Sociale dhe Rinisë në këto procese gjyqësore.

➤ Nga pikëpamja materiale:

Nga ana e palës paditëse kërkohet të anulohet Vendimi Nr. 665/1 Prot., datë 03.02.2017 i Komisionit të Përkohshëm të Urdhrit të Psikologut dhe si rrjedhojë anulimi i procesit të votimit për zgjedhjet e para për Urdhërin e Psikologut të datës 28.01.2017 dhe

perseritja e zgjedhjeve per Presidentin dhe Keshillin Kombetar te Urdhrit te Psikologut.

Procesi administrativ përfaqëson një varg aktesh, të dhënash dhe veprimesh materiale, të nxjerra këto nga një ose shumë organe dhe njësi organizative administrative, të lidhur midis tyre për realizimin e një qëllimi të vetëm; nxjerrjen e një akti administrativ. Procedimi administrativ është një koncept relativisht i ri për legjislacionin tonë të drejtës administrative, por kjo gjë nuk mund të thuhet për ato vende ku e drejta administrative ekziston prej kohësh si një degë e kristalizuar e të drejtës publike.

Për “procedimin administrativ” ka filluar të flitet nga fundi i shekullit të kaluar, me qëllimin për të treguar tërësinë e akteve të nxjerra nga autoritetet administrative të lidhur midis tyre me një qëllim të vetëm.

Në nenin 2 të ligjit nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative” është përcaktuar se:

“Veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ.

“*Veprimi tjetër administrativ*” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm...”

Pala paditëse ka pretenduar se Presidenti i Urdhrit te Psikologut eshte zgjedhur ne kushtet e parregullsive qe lidhen me kuorumin e kërkuar prej ligjit dhe konkretisht kerkon pika 3, a, e nenit 15 te ligjit 40/2016:

“, *Asambleja Kombetare zgjedh Keshillin Kombetar dhe Presidentin e Urdhrit “... me shumice te thjeshte te te gjithë anetareve te saj”*”

Doktrina ka sqaruar se:

Një akt administrativ është i ligjshëm, nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative (KPA), si dhe në legjislacionin në fuqi. Ky është kuptimi që jep neni 107 i KPA-së, për ligjshmërinë e aktit administrativ. Mosrespektimi i këtyre kushteve sjell pavlefshmërinë e aktit, e cila vlerësohet në varësi të mangësisë së përmbajtjes së tij, të kompetencës së organit publik, ose të shkallës së shkeljes të procedurës dhe formës së kërkuar nga ligji.

Ashtu siç trajtohet nga doktrina e të drejtës civile dhe e të drejtës administrative, Kodi i mëparshëm i Procedurave Administrative dhe legjislacioni administrativ kanë njohur dy lloje të pavlefshmërisë.

Me parashikimin që bënte Kodi i vitit 1999 evidentonte vetëm rastet kur akti është absolutisht i pavlefshëm, pa dhënë ndonjë kuptim të saktë për aktet administrative relativisht të pavlefshme. Në varësi të seriozitetit të shkeljes, ose të shkallës së intensitetit të paligjshmërisë, bëhet edhe ndarja. Pra, ndryshe nga Kodi Civil, ku koncepti i pavlefshmërisë ka gjetur një rregullim të shprehur qartë në dispozita të veçanta të tij, në legjislacionin administrativ ky rregullim ka qenë i pjesshëm. Për më tepër, Kodi aktual i Procedurave Administrative nuk e bën më këtë parashikim për llojet e pavlefshmërisë së aktit. Ndarja e re pranon konceptin e pavlefshmërisë absolute dhe të paligjshmërisë së akteve administrative.

Në Kodin aktual të Procedurave Administrative ka një parashikim të ndryshëm nga Kodi i mëparshëm lidhur me pavlefshmërinë e akteve administrative. Koncepti i pavlefshmërisë relative të aktit është zëvendësuar me paligjshmërinë.

Kështu, në Seksionin 3 të Pjesës së Pestë të KPA-së, të titulluar “Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrativ”, parashikohet pavlefshmëria absolute dhe paligjshmëria e akteve administrative.

Për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit, një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk e ka fuqinë juridike të një akti të vlefshëm dhe objektivist konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast. Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk është akt.

Pavlefshmëria absolute e aktit është një gjendje e tillë, ku ka mungesë të plotë të efekteve juridike nga akti. Akti që në momentin e nxjerrjes së tij nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike, për të cilat është nxjerrë. Ai është një nulitet i plotë, një akt i dështuar, i cili nuk ka hyrë kurrë në fuqi. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj personave a subjekteve, të cilëve u drejtohet dhe, si njedhojë, këta ose çdo organ tjetër mund të kundërshtojnë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve a urdhërimeve që rrjedhin prej tij ose mund ta mënjanojnë atë, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë të shprehet domosdoshmërisht ndonjë organ. Sipas nenit 110 të KPA-së :

“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.”

Për rrjedhojë “ai konsiderohet se nuk ekziston.”

Pra, pavlefshniëria absolute është një situatë e tillë që konstatohet nga organi që e ka nxjerrë aktin, nga një organ më i lartë administrativ ose nga gjykata. Çdo subjekt publik a privat, që ndesh një akt të tillë, nuk i nënshtrohet rregullave të tij dhe nuk e merr parasysh gjatë veprimtarisë së tij. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të injorohet tërësisht nga personat e interesuar ose nga autoritetet e tjera administrative. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk mund të ndreqet as në të ardhmen, sepse objektivist konsiderohet se nuk ka ekzistuar për asnjë çast. Prandaj, kur organi administrativ ose gjykata gjatë shqyrtimit të një çështje ndeshen me një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, nuk shpallin deklarin e pavlefshmërisë, por përqendrohen vetëm në konstatimin e faktit të pavlefslimërisë. Nisur nga kjo, ata zgjidhin konfliktin administrativ dhe rregullojnë pasojat juridike të palëve.

Kodi i Procedurave Administrative nuk formulon ndonjë afat kohor për konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ. Akti absolutisht i pavlefshëm mund të injorohet tërësisht nga individit në ljalë, palët e treta, autoritete të tjera administrative, si dhe nga autoriteti që e ka marrë atë. Çdokush, në çdo kohë dhe në çdo çështje mund të konstatojë pavlefshmërinë e aktit. Nuliteti i një akti administrativ konstatohet në çdo kohë lidhur me procedurat për pavlefshmërinë e një akti administrativ. Kjo mund të konstatohet edhe pas kalimit të afatit në çdo procedure të rastit apo indirekte. Nga pala e interesuar mund të ushtrohet e drejta e ankimit vetëm për konstatimin dhe jo për deklarin e pavlefshmërisë absolute të aktit. Edhe padia që ngrihet nga subjekti konkret, si dhe vendimi që merret nga gjykata, janë të llojit vërtetimi, pra njohjeje. Pra, vetëm një padi deklarative, dhe jo një padi shfuqizuese paraqitet ndaj akteve absolutisht të pavlefshme.

Për shkak të natyrës që ka pavlefshmëria absolute, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk mundet të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëvonshëm, qoftë ky pëlqim ose miratim i palëve pjesëmarrëse në të. Njëkohësisht akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk merr vlerë juridike, as me kalimin e afatit të parashkrimit dhe as me zhdukjen e shkakut të pavlefshmërisë.

Akti administrativ do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, sipas parashkimit të

nenit 108 të KPA-së, në këto raste :

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Në rastin konkret veprimtaria e ushtruar në bazë të se cilës është zgjedhur Presidenti i Urdhrit është kundërshtuar për shkak të procedurës se ndjekur:

Respektimi i procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ përbën një nga elementet më të rëndësishme të ligjshmërisë së tij. Shkelja e procedurës mund të paraqitet me të gjitha mënyrat, por e rëndësishme është të kuptohet se jo të gjitha shkeljet që lidhen me procedurën mund të sjellin detyrimisht pavlefshmërinë absolute të aktit. Mosrespektimi i elementeve procedural duhet të jenë të atij karakteri dhe të asaj rëndësie që të kenë ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit administrativ. Prandaj edhe dispozita konkrete e KPA-së përdor shprehjen kur akti “është në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij”.

Si rregull i përgjithshëm, një akt administrativ është i pranueshëm edhe kur nuk respektohet ndonjë kërkesë procedurale, në rast se një shkelje e tillë nuk do të sillte ndryshim në përmbajtjen e aktit.

Ky është kuptimi që jep edhe neni 40, pika 4 i ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, sipas të cilit “Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.”.

Vetëm kur shkelja që i bëhet procedurës së aktit është kryer në mënyrë flagrante, atëherë një veprim i tillë sjell nulitetin e aktit. Kështu p.sh., shkelja e parimit procedural të dëgjimit të palëve, ose mosrespektimi nga organi i afateve brenda të cilit pranohet për shqyrtim një kërkesë, ose përfundon procesi administrativ, ndërkohë që ligji kërkon respektimin e tyre, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm.

Ne rastin në gjykim në ligjin nr 40/2016 “Për Urdhrin E Psikologut Në Republikën E Shqipërisë” në nenin 15 të tij është parashikuar se:

“1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe *përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.*

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

a) Presidenti i Urdhrit;

b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

3. Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

a) zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;”

Duke iu referuar formulimit të mesipërm Gjykata cmon se Presidenti i Urdhrit zgjidhet me 50% +1 anëtar të të gjithë anëtareve të Asamblese Kombetare.

Sipas nenit 15 të ligjit 40/2016 :

“Asambleja Kombëtare

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit **dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.**”

Interpretimi që i ben pala e paditur është i pambështetur në atë literal dhe teleologjik të kësaj dispozite,

Nëse ligjevenesi do të kishte qëllim që Presidenti të zgjidhej me shumicën e anëtareve prezent në mbledhjen e Asamblese (sikurse ka ndodhur) parashkimi ligjor do të ishte si me poshtë vijon:

“**zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës të saj.**”

Fakti që ligjvënësi ka parashikuar këtë lloj shumice , pra **të të gjithë anëtareve të Asamblese Kombetare** lidhet me qëllim dhe rëndësinë thelbësore që ka procesi për përzgjedhjen e Presidentit të Urdhrit të Psikologut.

Nëpërmjet këtij kuorumi dhe rezultati është kërkuar që kandidatura fituese të gëzojë besimin e shumicës së të gjithë anëtareve të Urdhrit.

Në lidhje me konceptin e shumicës së thjeshtë dhe asaj të cilesuar Gjykata Kushtetuese është shprehur në një sërë vendimesh si psh ai me nr 5 date 05.02.2014:

“...Gjykata i shqyrton pretendimet e kërkuarve në përputhje me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 1, pika 1 të Kushtetutës, që përcakton se: “Shqipëria është Republikë parlamentare”; në nenin 2, ku përcaktohet se:

“1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.

2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt”; në nenin 4/1 ku përcaktohet se:

“E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”;

në nenin 116 që përcakton hierarkinë e burimeve të së drejtës.

45. Kushtetuta, në nenin 78 parashikon se Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.

..... Në jurisprudencën kushtetuese, koncepti i shumicës së votave lidhet, në kuptimin primar të saj, me votimin pro ose kundër të gjysmës së votave të anëtarëve të organit që voton plus një votë, ndryshe e njohur si “shumicë e thjeshtë” (shih vendimet nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 44, datë 7.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese). 46. Në vështrim të përmbajtjes së normës kushtetuese, Gjykata konstaton se nga rregulli i përgjithshëm i vendimmarrjes me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi bëjnë përjashtim tërësia e ligjeve, në lidhje me të cilat normat kushtetuese, shprehimisht, parashikojnë një shumicë të cilësuar për miratimin e tyre....

Për më tepër, respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar” është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin (shih vendimin nr.23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese). ”

Në këtë këndvështrim procesi dhe veprimet për zgjedhjen e Presidentit të Urdhrit të

Psikologut konsiderohen absolutisht te pavlefshme duke qënë se procesi zgjedhor dhe rezultati përfundimtar është marrë në kundërshtim me nenin 15 /3 a te ligjit 40/2016.

Sipas Nenit 110 te Kodit te Procedurave Administrative:

“1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtoje mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.

3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme saqë organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm...”

Pavarësisht mënyres se formulimit te kerkimeve dhe pretendimeve te pales paditese

Gjykata cmon se duhet te zbatoje praktikën e Gjykatës së Lartë e cila me vendimin nr 399 datë 25.06.2014 ka argumentuar se:

“Është tashmë praktikë e konsoliduar gjyqësore se është detyrë e gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen të kuptojë drejt natyrën e konfliktit te krijuar mes palëve, shkakun ligjor te kërimit, përcaktimin e drejte te ligjit te zbatueshëm dhe si rezultat të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi ne përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej tyre.

.....

kur në një gjykim paraqiten kërtime të llojit si më sipër, pra kur kërkohet edhe pavlefshmëria absolute e akteve administrative dhe pavlefshmëria relative e tyre, gjykatat në radhë të parë do të marrin në shqyrtim dhe do të hetojnë nëse jemi përpara shkaqeve ligjore të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative objekt gjykimi. Dhe vetëm në rast se rezulton se këto akte nuk janë absolutisht të pavlefshme, gjykata merr në shqyrtim, heton, dhe vendos në lidhje me kërkimet e paditësit për pavlefshmërinë relative të aktit administrativ....”

Për sa më sipër, Gjykata mban parasysh vendimin Unifikues të Vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.3 datë 29.03.2012, vendim, i cili ka unifikuar praktikën se:

“...përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti ipadisë” dhe “baza ligjore” e saj. ...Objekti ipadisë dhe shkakun i saj nuk përmbledhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to”. ... Në këtë kuptim, gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar pudinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj.

..... Parimi iura novit curia në këtë rast do të thotë se gjykata nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit, e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, të bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta Po ashtu, gjykata nuk lidhet as me përcaktimin që palët mund t'i bëjnë fakteve të çështjes, ndonëse ka detyrimin, konform

11

→ a nuk legjionax kjo po
cmon te kërkesë e cille shqyrton
te pavlefshme te Kodit nr. 40/2016

nenit 10 të K.Pr. Civile, që të mbështesë vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit. Gjykata vërtet e mbështet vendimin tek faktet e paraqitura gjatë gjykimit, por vlerësimin e tyre e bën në mënyrë të pavarur, d.m.th. nuk i merr të mirëqena përcaktimet e palëve, por pasi analizon provat e marra gjatë gjykimit e vlerëson vetë ekzistencën e fakteve me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Gjykata madje ka të drejtë që tëfojë palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9 i K.Pr.C.). Pra, gjykata nuk lidhet me përcaktimin që bëjnë palët në lidhje me faktet apo me ligjin që zbatohet për këto fakte”.

Fakti që ka përfunduar afati 8 mujor për realizimin e zgjedhjeve nuk mund të shërbejë si shkak për “*imunitet*” të këtij procesi me të meta thelbësore. Tejkalmi i afatit 8 mujor nga hyrja në fuqi e ligjit nuk mund të shërbejë si shkak për cënimin e të drejtës për t’u drejtuar Gjykatës dhe ai si rekuperues për pavlefshmerinë absolute.

Aq më tepër kur Gjykata cmon se vete procesi zgjedhor është realizuar tej afatit 8 mujor të parashikuar në ligjin e botuar në Fletoren Zyrtare nr 77 date **09.05.2016**

Ligji ka hyre në fuqi 15 dite nga botimi në fletoren Zyrtare pra në datën **24.05.2016** duke lënë afat për organizimin e zgjedhjeve të para deri në datën **24.01.2017**.

Gjithsesi Gjykata mori në shqyrtim këto pretendime duke qënë se ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i jep të drejtë Gjykatës të shqyrtojë veprimin apo aktin administrativ sipas Nenit 37 i cili parashikon se:

“ *Kufijtë e shqyrtimit të çështjes*

1. *Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.*

2. *Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkon një nxjerrje të një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit...”*

Tejkalmi i këtij afati kushtëzon Gjykatën në lidhje me kërkimin për detyrimin e përsëritjes së zgjedhjeve e cila është në kompetencën e Kuvendit të Shqipërisë i cili nëpërmjet parashikimeve ligjore do të rregullojë në vijim këtë proces.

Nga sa më sipër pavarësisht konstatimit pjesërisht të paligjshmërisë së Vendimit Nr. 665/1 Prot., date 03.02.2017 të Komisionit të Perkohshëm të Urdhrit të Psikologut, Gjykata është në pamundësi për të rregulluar pasojat për shkak të mungesës së kompetencës.

Përfundimisht Gjykata cmon se kërkesë padia është pjesërisht e mbështetur në ligj e për pasojë duhet të pranohet pjesërisht.

PER KETO ARSYE

Në bazë të nenit 9 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 158/a të

K.Pr.Civile

VENDOSI

1. Pranimin pjesërisht te kerkese padise.
2. Konstatimin pjesërisht absolutisht te pavlefshem te aktit nr 665/I date 03.02.2017 I Komisionit te Perkohshem te Urdheri te Psikologut dhe si rrjedhoje anulimi I veprimeve per zgjedhjet e para per Urdhrin e Psikologut persa I perket Presidentit te Urdherit te Psikologut.
3. Rrezimin per pjesen tjeter te kerkese padise.
4. Shpenzimet procedurale ne ngarkim te pales se paditur .
5. Kunder ketij vendimi lejohet ankimbrenda 15 diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane. Per palet ne mungese ne shpallje ky afat fillon te llogaritet nga e nesermja e marrjes dijeni per vendimin.

U shpall sot ne Tiranë në datë 22.05.2017!

SEKRETARE

ELONA DERVISHI

GJYQTARE

ELVANA ÇIÇOLLI